



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



RREGULLA E PROCEDURËS SË AUTORIZIMIT PËR NDËRTIMIN E KAPACITETEVE TË REJA, PËRFSHIRË PROCEDURËN E THJESHTËZUAR PËR KAPACITETE TË VOGLA GJENERUESE

Prishtinë, ... 2017



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, sipas autoritetit të dhënë me Nenin 9, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenin 15, paragrafi 1, nënparagrafi 1.15, Nenin 26 dhe Nenin 43 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084, në seancën e mbajtur me -----2017, miratoi:

RREGULLËN E PROCEDURËS SË AUTORIZIMIT PËR NDËRTIMIN E KAPACITETEVE TË REJA DHE PROCEDURËS SË THJESHTËZUAR PËR NDËRTIM TË KAPACITETEVE TË VOGLA GJENERUESE
KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

1. Kjo rregull përcakton procedurën e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, sistemeve të reja për bartjen dhe shpërndarjen e gazit, përfshirë interkonektorët, si dhe linjave direkte elektrike dhe gazsjellësit direk për bartjen e gazit natyror.
2. Kjo rregull përcakton edhe procedurën e thjeshtuar për ndërtimin e kapaciteteve të reja të vogla gjeneruese.

Neni 2

Fushëveprimi

1. Rregulla përcakton kriteret dhe procedurat për dhënien e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, sistemeve të reja për bartjen dhe shpërndarjen e gazit, përfshirë linjat interkonektive si dhe linjave direkte elektrike dhe gazsjellësit direk për bartjen e gazit natyror, në mënyrë që të krijojë kushte për shfrytëzim eficient dhe me kosto-efektive të energjisë, duke marrë parasysh madhësinë e tyre të kufizuar dhe ndikimin e mundshëm mjedisor.
2. Rregulla përcakton kriteret dhe procedurën e thjeshtuar për dhënien e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja të vogla gjeneruese.
3. Procedura e autorizimit do të zbatohet në përputhje me kriteret objektive, transparente dhe jodiskriminuese, e cila përkrah krijimin e një tregu konkurrues të energjisë duke nxitur investime dhe duke garantuar sigurinë dhe stabilitetin e sektorit të energjisë në Kosovë.
4. Me këtë rregull nuk do të ndalohej që ndonjë autoritet ekzistues apo institucion tjetër të lëshojë leje, pëlqime apo ndonjë dokument tjetër të nevojshëm për marrjen e Autorizimit të projektit për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese, sistemeve të reja për bartjen dhe shpërndarjen e gazit, përfshirë interkonektorët si dhe linjat direkte elektrike dhe gazsjellësin direk për bartjen e gazit natyror, në pajtim me ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës.



5. Kjo rregull nuk përfshin procedurën e tenderimit, të përcaktuar me Nenin 44 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.
6. Nëse një kapacitet i ri gjenerues, sistem i ri për bartjen dhe shpërndarjen e gazit, përfshirë linjat interkonektive si dhe linjat direkte elektrike dhe gazsjellësit direk për bartjen e gazit natyror, është objekt i tenderimit apo do të ndërtohet si rezultat i zbatimit të procedurës tenderuese, atëherë ai nuk do të nënshtrohet këtij rregulli për autorizim.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregull, kanë kuptimin si në vijim:
 - 1.1. **“Aplikues”** - personi fizik apo juridik i organizuar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar apo shoqëri aksionare, që kryen një apo më shumë veprimtari në sektorin e energjisë i cili kërkon marrjen e autorizimit sipas kësaj rregulle;
 - 1.2. **“ZRRE”** – Zyra e Rregullatorit për Energji;
 - 1.3. **“Vendimi për Autorizimin Preliminar”** – vendim i lëshuar nga Bordi i ZRRE-së, që tregon përshtatshmërinë e pritur të aplikantit për ndërtimin e stabilimentit të ri gjenerues, nëse aplikanti i plotëson kushtet dhe kërkesat e tjera që dalin nga legjislacioni në fuqi brenda periudhës së specifikuar kohore;
 - 1.4. **“Autorizim”** – dhënia e autorizimit për fillimin e ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese, sistemeve të reja për bartjen dhe shpërndarjen e gazit, përfshirë interkonektorët, si dhe linjat direkte elektrike dhe gazsjellësit direk për bartjen e gazit natyror, brenda periudhës së specifikuar kohore sipas kësaj rregulle;
 - 1.5. **“Stabiliment Prodhimi”** – të gjitha ndërtesat, instalimet dhe pajisjet, të bashkuara, për të gjeneruar energji elektrike, ngrohje ose kombinim të ngrohjes dhe energjisë elektrike (ko-gjenerimi), të lidhura në rrejtin përkatës;
 - 1.6. **“Studim i Fizibilitetit (Zbatueshmërisë)”** – vlerësim teknik, ekonomik dhe mjedisor i një projekti për ndërtimin e kapaciteteve të reja; dhe;
 - 1.7. **“Burime të Ripërtërishme të Energjisë”** – burim i ripërtërishëm, jofosil i energjisë si: energjia e erës, energjia diellit, energjia gjeotermale, energjia e ujit, energjia e valëve, biomasa, gaz mbetjeve urbane, gaz i mbetjeve të trajtimit të ujërave dhe biogazi; siç është përcaktuar në legjislacionin në fuqi për burimet e energjisë së ripërtërishme;
 - 1.8. **“MMPH”**- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;
 - 1.9. **“Organ kompetentet”**- organe përgjegjëse relevante të nivelit lokal dhe qendror të Republikës së Kosovës.



- 1.10. **“Kapacitete gjeneruese të mëdha”** – nënkupton kapacitetet e reja gjeneruese me kapaciteti me të madh se 100 kW (> 100 kW), të kyçur në rrjet;
- 1.11. **“Kapacitete gjeneruese të vogëla”** – nënkupton kapacitetet e reja e të vogla gjenerues me një kapacitet deri në 100 kW, të kyçur në rrjet;
2. Shprehjet e përdorura në këtë Rregull kanë të njëjtin kuptim si në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Ligjin për Energjinë, Ligjin për Energjinë Elektrike, Ligjin për Gazin Natyror dhe Ligjin për Ngrohjen Qendrore.

KREU II

AUTORIZIMI PËR NDËRTIMIN E KAPACITETEVE TË REJA

Neni 4

Obligimi për autorizim

1. Ashtu siç përcaktohet me Nenin 43 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, asnjë person fizik ose juridik nuk mund të ndërtojë një stabiliment (gjenerator) , të kyçet në rrjetin relevant, pa marrë paraprakisht një Autorizim me shkrim nga ZRRE-ja, në përputhje me procedurën e përcaktuar me këtë rregull.
2. ZRRE do t'i shqyrtojë të gjitha aplikacionet për Autorizim për ndërtimin e stabilimenteve të reja në përputhje me këtë rregull dhe do të sigurojë që aplikacionet e tilla do të shqyrtohen në mënyrë objektive, transparente dhe jodiskriminuese.

Neni 5

Aplikacioni për autorizim

1. Aplikimi për marrjen e Autorizimit për kapacitetet e mëdha gjeneruese duhet të bëhet me shkrim dhe në formën e specifikuar sipas shtojcës 1 të kësaj rregulle.
2. Aplikimi për marrjen e autorizimit për kapacitetet e vogla gjeneruese, duhet të bëhet me shkrim dhe në formën e specifikuar sipas shtojcës 2 të kësaj rregulle.
3. Kur ZRRE pranon një aplikacion për marrje të Autorizimit, do të shqyrtojë atë, dhe në përputhje me këtë rregull lëshon:
 - 3.1. Vendim për lëshimin e Autorizimit Preliminar,
 - 3.2. Vendim për lëshimin e Autorizimit Final; dhe
 - 3.3. Vendimin mbi refuzimin e Autorizimit Preliminar ose Autorizimit Final.
4. Përgjatimisht nga paragrafi 2 nënparagrafi 2.1 i këtij neni, nëse aplikojnë më shumë se një aplikues për të njëjtin vend/lokacion ku do të ndërtohet stabilimenti i ri gjenerues, ZRRE do ta procedojë më tutje atë aplikacion i cili ka siguruar dëshmi relevante lidhur me të drejtën e



shfrytëzimit të tokës, kurse në rast të Hidrocentralit, aplikacioni i cili përmban Pëlqimin Ujor të lëshuar nga organi kompetent.

5. Nëse ZRRE e konsideron të nevojshme mund të kërkojë që aplikanti të sjellë dokumente shtesë në përputhje me këtë rregull.

Neni 6

Kriteret për marrjen e autorizimit

1. Aplikuesi që aplikon për marrjen e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja, sipas kësaj rregulle, gjatë të gjitha fazave të aplikimit duhet të respektojë të gjitha ligjet, aktet nënligjore dhe rregulloret në fuqi.
2. Projektet duhet të sigurojnë:
 - 2.1. arritjen e nivelit të sigurisë që ka të bëjë me personelin, pajisjet, instalimet, makineritë dhe mbrojtjen e mjedisit;
 - 2.2. ngritjen e konkurrencës në përputhje me zhvillimin e një tregu të liberalizuar të energjisë;
 - 2.3. përputhjen me Strategjinë e Sektorit të Energjisë të Republikës së Kosovës dhe legjislacionin e aplikueshëm për burimet e ripërtëritshme të energjisë;
 - 2.4. kapacitete teknike, financiare, burime njerëzore, njohuri dhe strukturë organizative për ndërtimin dhe operimin e stabilimentit energjetik;
 - 2.5. përdorimin e pajisjeve të fundit moderne (me efikasitet /rendiment sa më të lartë) për stabilimentin përkatës;
 - 2.6. planet për largimin (dekomisionimin) e të gjitha mbeturinave që lidhen me prodhim dhe heqjen nga përdorimi dhe/ose largim të stabilimenteve të gjenerimit në fund të periudhës së dobishme të jetëgjatësisë, në përputhje me kërkesat teknike dhe ambientale; dhe
 - 2.7. të drejtën pronësore dhe të drejta të tjera ligjore për ndërtim në lokacionin përkatës, ashtu siç është propozuar në projektin për ndërtimin e kapaciteteve të reja.

KREU III

PROCEDURA PËR LËSHIMIN E AUTORIZIMIT

Neni 7

Procedura e aplikimit

1. Aplikacioni për autorizim për kapacitete të mëdha gjeneruese do të plotësohet dhe dorëzohet në ZRRE në formatin e specifikuar sipas Shtojcës 1 të kësaj rregulle.
2. Aplikacioni për autorizim duhet të shoqërohet me dokumentet vijuese:



- 2.1. certifikatë të regjistrimit të aplikantit si Organizatë Afariste, që i është lëshuar nga agjencia e autorizuar për regjistrimin e organizatave afariste;
- 2.2. Statutin e themelimit të shoqërisë;
- 2.3. informacione/tregues në lidhje me situatën financiare të aplikantit, Raportin Vjetor Financiar të Audituar për tre (3) vitet e fundit, e vërtetuar nga institucioni kompetent ose nga auditorët financiarë të certifikuar;
- 2.4. Studimin e Fizibilitetit (zbatueshmërisë) të bërë për kapacitetet e reja gjeneruese, sistemet e reja për bartjen dhe shpërndarjen e gazit, përfshirë interkonektorët, si dhe linjat direkte elektrike dhe gazsjellësin direkt për bartjen e gazit natyror;
- 2.5. Planin e Biznesit (duke përfshirë edhe: Koston totale të investimeve dhe mënyrën e financimit; Vlerësimin ekonomik – financiar të projektit duke përfshirë pasqyrat financiare; Vlerësimin statik dhe vlerësimin dinamik të efikasitetit të investimeve (PBP, NPV,IRR dhe BP); Analizat e ndjeshmërisë NPV,IRR, PBP dhe LDC (kosto njësi marginale) përkundrejt investimit total, të hyrave dhe kostos së O&M si dhe Konkluzione dhe rekomandimet sipas projektit;
- 2.6. marrëveshje për kyçje në rrjet (informatën teknike, pëlqimin elektroenergjetik), për kapacitetin e ri gjenerues;
- 2.7. dëshmi mbi aftësitë teknike, financiare si dhe përvojën e aplikantit për të ndërtuar, poseduar ose drejtuar projekte gjeneruese;
- 2.8. dëshmi nga gjykata kompetente që aplikanti nuk është në procedurë likuidimi/falimentimi, që biznesi i tij nuk administrohet nga gjykata dhe që aktivitetet e tij komerciale nuk janë të pezulluara;
- 2.9. dëshmi nga organi kompetent që aplikanti i përmbush detyrimet ligjore lidhur me pagimin e taksave në vendin ku është regjistruar si person juridik;
- 2.10. informacione në lidhje me strukturën organizative, përfshirë biografitë e menaxhmentin dhe personelin profesional të aplikantit,;
- 2.11. Dëshmi lidhur me të drejtën për shfrytëzim të tokës dhe për gjendjen pronësore të tokës që do të përdoret për ndërtimin e Stabilimentit të ri (vendimin për dhënie të pëlqimit për investime nga organi kompetent lokal apo qendror, marrëveshjet/kontratat për shfrytëzim të tokës private ose publike, fletët poseduese, kopjet e planit etj.).
- 2.12. Dëshmi që konfirmojnë se Stabilimenti i planifikuar që do të ndërtohet, do të jetë në pajtueshmëri me ligjet mjedisore në Kosovë (Pëlqimin Mjedisor, Lejen Mjedisore pas ndërtimit të gjeneratorit të ri).



- 2.13. Dëshmi nga autoritetet relevante që konfirmojnë se aplikuesi i ka plotësuar të gjitha kërkesat e aplikueshme statusore sipas legjislacionit relevant në Kosovë (varësisht prej projektit), përfshirë edhe të drejtat mbi shfrytëzimin e ujit, aty ku kërkohet.
- 2.14. Dëshmi për llojin, sigurinë, kualitetin e paneleve solare/fotovoltaike si dhe certifikatën mbi riciklimin (TUV certifikata), aty ku kërkohet.
3. Aplikacioni i thjeshtëzuar për ndërtim të kapaciteteve të vogla gjeneruese do të plotësohet dhe dorëzohet në ZRRE në formatin e specifikuar sipas Shtojcës 2 të kësaj rregulle
4. Nëse aplikanti vepron në emër të një shoqërie aksionare, partneriteti apo konzorciumi, ose shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, niveli i kualifikimit të investitorit do të vlerësohet bazuar në informacionin, përfshirë atë financiar, që ka të bëjë me çdo anëtar të asociacionit dhe që i dërgohet ZRRE-së nga përfaqësuesi i autorizuar i shoqërisë.
5. Pas pranimit të aplikacionit, ZRRE do ta regjistroj atë në regjistrin e aplikacioneve. Regjistri do të publikohet në ueb faqen zyrtare elektronike të ZRRE-së.
6. ZRRE do të sigurojë që aplikacioni dhe të gjitha dokumentet e bashkangjitura dhe informacionet e tjera të regjistrohen, të arkivohen dhe mund të vihen në dispozicion publik në zyrat e ZRRE-së.
7. Në konsultim me aplikuesin, ZRRE mund të vendosë se cilat të dhëna ose dokumente do të konsiderohen konfidenciale, në përputhje me Rregullën për Informatat Konfidenciale, dhe dokumentet e tilla nuk do të bëhen publike.

Neni 8

Taksat për aplikim

1. Të gjithë aplikuesit që aplikojnë për marrjen e Autorizimit, do të paguajnë taksën administrative për shqyrtimin e aplikacionit, në shumën e specifikuar nga ZRRE-së.
2. Aplikuesi duhet të sjellë kopjen e faturës së taksës së paguar, brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike, pas dorëzimit të aplikacionit për marrjen e autorizimit.
3. Pagesa nuk rimbursohet në rast të refuzimit të lëshimit të autorizimit.

Neni 9

Regjistrimi i aplikacioneve

1. Aplikacioni me të gjitha dokumentet shoqëruese do të dorëzohet në një (1) origjinal dhe në një (1) kopje elektronike në CD.
2. Aplikacioni do të dorëzohet në një nga gjuhët zyrtare në Kosovë.
3. Në rast se ndonjë dokument i bashkangjitur aplikacionit nuk është në një gjuhë zyrtare në Kosovë, ZRRE mund ta pranoj si të tillë ose të kërkoj nga aplikuesi që të përkthimin e tij në një nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës dhe të vërtetuar nga noteri.



Neni 10

Publikimi i aplikacioneve

1. Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas kompletimit të aplikacionit për kapacitet e mëdha gjeneruese, sipas Nenit 7, paragrafit 1 të kësaj rregulle, aplikuesi duhet të publikojë në dy (2) gazeta ditore me shtrirje në tërë territorin e Kosovës:
 - 1.1. një përmbledhje të shkurtër të përmbajtjes së aplikacionit;
 - 1.2. një njoftim se çdo palë e interesuar mund të shprehë interes apo të kundërshtojë projektin e tillë brenda tetë (8) ditësh kalendarike në ZRRE, nga data e shpalljes së njoftimit.
2. Nëse ZRRE ka pranuar ndonjë kundërshtim për aplikacionin, do t'ia paraqesë një kopje aplikuesit dhe do ta publikojë në ueb faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
3. Në rast të paraqitjes së ndonjë kundërshtimi, sipas paragrafit 2 të këtij neni, ZRRE do ta ndërpresë shqyrtimin e aplikacionit dhe do ta njoftojë me shkrim aplikuesin, deri në zgjidhjen e kontestit.
4. Aplikuesi dhe/ose ZRRE-ja nuk do të zbulojnë asnjë informacion që klasifikohet si konfidencial, në përputhje me Rregullën për Informatat Konfidenciale.
5. Dispozitat e këtij Neni nuk do të zbatohen në rast të ndërtimit të gjeneratorëve të vegjël

Neni 11

Dorëzimi i informacioneve plotësuese

1. Në rast se ZRRE vlerëson se i duhen më shumë informacione ose sqarime nga një aplikues, atëherë ZRRE, brenda tridhjetë (30) ditësh kalendarike nga data e pranimit të aplikacionit për kapacitetet e mëdha gjeneruese dhe jo më vonë se njëzetë (20) ditë kalendarike për kapacitetet e vogla gjeneruese, do të kërkojë nga aplikuesi që të dorëzojë me shkrim informacione dhe të dhëna shtesë.
2. Kërkesa e ZRRE-së ndaj aplikuesit për sqarim ose informacion dhe të dhëna shtesë do të përmbajë afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh kalendarike brenda të cilit aplikuesi do të dorëzojë përgjigjen e tij. ZRRE mund ta shtyjë afatin në rast se aplikuesi me shkrim arsyeton mosarritjen e përmbushjes së afatit përfundimtar.
3. Nëse aplikuesi vonon pa arsye bindëse përgjigjen e kërkuar, ZRRE ka të drejtën ta refuzojë aplikacionin pa njoftim paraprak dhe pa rimbursuar taksën e shqyrtimit të aplikacionit, ose të vendosë mbi aplikacionin, bazuar në dokumentet dhe informacionet ekzistuese dhe ta njoftojë aplikuesin për vendimin e saj. Aplikacioni i tillë do largohet nga Regjistri i Aplikacioneve.
4. Pas përcaktimit se për aplikacionin nuk kërkohen sqarime, informacione dhe të dhëna shtesë, ZRRE do të njoftojë aplikuesin se aplikacioni konsiderohet i kompletuar.



5. Pavarësisht nga dispozitat ligjore të kësaj rregulle, ZRRE ka të drejtë të kërkojë informacione dhe të dhëna shtesë nga aplikuesi, në çdo kohë gjatë dhe pas marrjes së autorizimit.

KREU IV AFATET DHE VENDIMET PËR AUTORIZIM

Neni 12

Afatet për shqyrtimin e aplikacionit për autorizim

ZRRE do të marrë një vendim formal për secilin aplikacion për kapacitetet e mëdha gjeneruese brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh kalendarike ose katërdhjetepesë (45) ditë kalendarike për kapacitetet e vogla gjeneruese nga data kur e ka njoftuar aplikuesin se aplikacioni konsiderohet i kompletuar "gatshëm", sipas kushteve të Nenit 11, paragrafit 4, të kësaj rregulle, por nëse konsiderohet e nevojshme, atëherë mund të përcaktojë zgjatjen e afatit për shqyrtimin e aplikacionit për një periudhë shtesë deri në tridhjetë (30) ditë kalendarike për gjeneratorët e mëdhenj dhe deri në pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike për gjeneratorët e vegjël.

Neni 13

Vendimet e ZRRE-së mbi aplikacionet për autorizim

1. Nëse ZRRE përcakton se aplikuesi i ka përmbushë kërkesat dhe kriteret e përcaktuara me këtë rregull dhe me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, atëherë:
 - 1.1. Do ta lëshojë Vendimin për Autorizimin Preliminar që konfirmon se aplikuesit do t'i jepet një Autorizim Final në bazë të disa kushteve të caktuara që duhet të përmbushen brenda periudhës së specifikuar kohore; ose
 - 1.2. Do të lëshojë Autorizim Final për ndërtim të stabilimentit që ka qenë lëndë e aplikacionit, nëse ZRRE është e bindur se janë plotësuar të gjitha kushtet e tjera të nevojshme dhe vlerëson se mund të lëshohet autorizimi.
2. Vendimi i ZRRE-së, për lëshimin e Vendimit për Autorizimin Preliminar ose Autorizimin Final do t'i dorëzohet aplikuesit, sipas kësaj rregulle dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Neni 14

Lëshimi i Vendimit për Autorizimin Preliminar

1. ZRRE do t'i lëshojë aplikuesit vendimin për Autorizimin Preliminar nëse, është vërtetuar se aplikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë e tij për ndërtimin e stabilimentit të ri, porse nuk ka plotësuar ende kërkesat sipas paragrafit 4 të këtij neni që dalin nga legjislacioni në fuqi lidhur me ndërtimin e stabilimentit.
2. Vendimi për Autorizimin Preliminar i lëshohet subjekti juridik i cili ka aplikuar për marrjen e autorizimit dhe nuk mund të bartet apo transferohet në ndonjë subjekt tjetër juridik.



3. Vendimi për Autorizimin Preliminar lëshohet për kapacitetin e instaluar, lokacionin përkatës dhe nuk mund të transferohet në ndonjë lokacion tjetër.
4. Vendimi për Autorizimin Preliminar nuk i jep të drejtë bartësit që të vazhdojë ndërtimin e stabilimentit të ri para se t'i plotësojë të gjitha kushtet dhe kërkesat e duhura dhe t'i jetë lëshuar Autorizimi Final në përputhje me këtë rregull.
5. Vendimit për Autorizimin Preliminar do ti jap prioritet aplikuesit në përfshirje në Skemën Mbështetëse për prodhim të energjisë elektrike nga BRE, të përgatitur nga ZRRE, e si rrjedhojë edhe marrjen e tarifës nxitëse.
6. Vendimi për Autorizimin Preliminar mund të lëshohen edhe nëse nuk janë plotësuar kërkesat si në vijim: Marrëveshja për kyçje në rrjet, Leja për Ndërtim, Pëlqimi Ujor dhe Leja Ujore në rast të Hidrocentraleve dhe Projekti final i zbatimit. Këto kërkesa duhet të sillen me rastin e parashtrimit të kërkesës për shndërrimin e Vendimit për Autorizimin Preliminar në Autorizim Final, sipas neni 15 të kësaj Rregulle.
7. Vendimi për Autorizimin Preliminar do të përcaktojë se aplikuesit do t'i lëshohet Autorizimi Final për gjeneratorët e mëdhenj brenda dymbëdhjetë (12) muajsh ose brenda gjashtë (6) muajsh për gjeneratorët e vegjël, varësisht se kur aplikuesi do t'i plotësojë kërkesat si në vijim:
 - 7.1. të bëjë një kërkesë me shkrim duke kërkuar që t'i lëshohet Autorizimi Final;
 - 7.2. të dorëzojë në ZRRE të gjitha dëshmitë relevante që kërkohen me legjislacionin në fuqi; dhe
 - 7.3. të përmbushë çfarëdo kushti tjetër të përcaktuar në Vendimit për Autorizimin Preliminar.
8. Afati i përcaktuar me paragrafin 5 të këtij neni mund të shtyhet edhe për një afat gjashtë (6) muaj për gjeneratorët e mëdhenj ose për tjerët tre (3) muaj për gjeneratorët e vegjël nëse aplikuesi në kërkesën e tij me shkrim e arsyeton bindshëm shtyrje të afatit.
9. Pas skadimit të afatit të përcaktuar me paragrafin 6 të këtij neni, Vendimit për Autorizimin Preliminar do të shfuqizohet në mënyrë automatike, dhe nuk do shqyrtohet nga Bordi i ZRRE-së.
10. Aplikuesi i njëjtë, me të njëjtin projekt, mund të aplikojë vetëm edhe një herë për marrjen e Vendimit për Autorizimin Preliminar duke i rifreskuar të gjitha lejet përkatëse sipas legjislacionit në fuqi. Aplikacioni i tillë do të trajtohet në përputhje me këtë Nen, me përjashtim të paragrafit 6 të këtij Neni.
11. Aplikuesi sipas paragrafit 8 të këtij neni, me rastin e riaplikimit duhet të bëjë kërkesë me shkrim, duke arsyetuar kërkesën e tillë, dhe duke dëshmuar se për shkak të vonesave nga institucionet lokale apo qendrore në lëshimin e Lejes së ndërtimit për projektet relevante, nuk ka mundur të bëjë kërkesë për shndërrimin e Autorizimin Preliminar në Autorizim Final brenda afatit të përcaktuar ligjor.



Kërkesa për shndërrimin e Autorizimin Preliminar në Autorizim Final

1. Kërkesa që Autorizimi Preliminar të shndërrohet në Autorizim Final për ndërtimin e stabilimentit të ri duhet të shoqërohet me dëshmitë si në vijim:
 - 1.1. dëshmi të specifikuar për gjeneratorët e mëdhenj sipas Nenit 7, paragrafi 1, të kësaj rregulle dhe për gjeneratorët e vegjël sipas nenit 7 paragrafi 3 të kësaj rregulle, që janë dorëzuar ose do të duhej të ishin dorëzuar së bashku me aplikacionin kur është lëshuar Vendimi për Autorizimin Preliminar.
 - 1.2. dëshmi nga autoritetet relevante se aplikuesi i ka përmbushur të gjitha kërkesat e tjera ligjore që lidhen me natyrën e projektit sipas legjislacionit në fuqi.
2. Dëshmitë që duhet të sillën për shndërrimin e Vendimit për Autorizimin Preliminar në Autorizim Final për gjeneratorët e mëdhenj janë si në vijim:
 - 2.1. E drejta për shfrytëzimin e tokës;
 - 2.2. Pëlqimin Elektroenergjetik;
 - 2.3. Pëlqimi Ujor në rast të Hidrocentraleve;
 - 2.4. Leja Ujore në rast të hidrocentraleve;
 - 2.5. Projekti final i zbatimit dhe
 - 2.6. Leja e ndërtimit e lëshuar sipas Ligjit për Ndërtimin në Republikën e Kosovës.
3. Dëshmitë që duhet të sillën për shndërrimin e Autorizimin Preliminar në Autorizim Final për gjeneratorët e vegjël janë si në vijim:
 - 3.1. Leja Mjedisore komunale dhe
 - 3.2. Leja e Ndërtimit.
4. Pas pranimit të kërkesës me dëshmitë relevante të cekura në paragrafin 2 ose 3 të këtij neni, ZRRE:
 - 4.1. Do ta regjistrojë kërkesën në regjistrin e aplikacioneve për autorizim;
 - 4.2. Sigurohet se kërkesa dhe të gjitha dëshmitë e bashkangjitura, si dhe dokumentet e tjera, janë regjistruar, arkivuar dhe janë në dispozicion publik në zyrën e ZRRE-së;
 - 4.3. Vendos cilat dokumente konsiderohen konfidenciale në përputhje me Rregullën për Informatat Konfidenciale.
5. Pas vlerësimit të dëshmimeve dhe të dhënave shtesë, ZRRE do të njoftojë aplikuesin se aplikacioni është vlerësuar si i kompletuar.
6. Pavarësisht nga dispozitat e tjera të kësaj rregulle, ZRRE ka të drejtë të kërkojë informacione dhe të dhëna shtesë nga aplikuesi në çdo kohë gjatë procedurës së autorizimit.

Neni 16

Dhënia e Autorizimit Final



1. ZRRE do të marrë vendim formal për secilin aplikacion brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh kalendarike për gjeneratorët e mëdhenj ose brenda katërdhjetepesë (45) ditësh kalendarike për gjeneratorët e vegjël, nga data në të cilën e ka njoftuar aplikuesin se aplikacioni është vlerësuar i kompletuar sipas Nenit 15, paragrafi 3 të kësaj rregulle, përveç nëse ZRRE e konsideron të nevojshme që të përcaktojë se periudha e shqyrtimit të aplikacionit mund të shtyhet edhe për një periudhë shtesë, që mund të zgjasë deri në tridhjetë (30) ditë kalendarike për gjeneratorët e mëdhenj ose pesëmbdhjetë (15) dite kalendarike për gjeneratorët e vegjël.
2. Nëse ZRRE përcakton se aplikuesi i ka plotësuar të gjitha kërkesat e duhura dhe kriteret sipas kësaj rregulle, do ta lëshon Autorizimin Final.
3. Autorizimi Final do të përcaktojë se aplikuesi duhet ta ndërtojë stabilimentin në afat prej dy (2) vjetësh për gjeneratorët e mëdhenj, dhe brenda një (1) viti për gjeneratorët e vegjël pas datës së lëshimit të Vendimit nga Bordi i ZRRE-së.
4. Afati i përcaktuar me paragrafin 3 të këtij neni mund të shtyhet edhe për një afat një (1) vjeçar për gjeneratorët e mëdhenj dhe gjashtë (6) muaj për gjeneratorët e vegjël, nëse aplikuesi në kërkesën e tij me shkrim e arsyeton bindshëm një shtyrje të afatit.
5. Në rastet specifike në lidhje me kapacitetet e reja gjeneruese, lokacionin specifik të ndërtimit etj, afati i përcaktuar në paragrafin 4 të këtij neni, me kërkesë të aplikuesit, mund të shtyhen edhe për një periudhë deri në dymbëdhjetë (12) muaj, nga Bordi i ZRRE, nëse aplikuesi me kërkesë e arsyeton shtyrjen e tillë.
6. Në raste kur kemi të bëjmë me projekte me kapacitete të mëdha gjeneruese, lokacione specifike të ndërtimit dhe kur projekti është realizuar më shumë se 70%, Bordi i ZRRE, sipas kërkesës së arsyetuar të palës, me Vendim mund ta lejoj edhe një afat shtesë që e konsideron të mjaftueshëm për përfundim të projektit.
7. ZRRE do të konsideroj projektin e finalizuar, nga data e sjelljes të certifikatës së përdorimit të lëshuar nga organi kompetent, sipas Ligjit për Ndërtimin.
8. Vendimi për lëshimin e Autorizimit final do të përcaktoj se aplikuesi duhet të pajiset me Leje Mjedisore (Ekologjike).
9. Çdo vendim i ZRRE-së mbi dhënien e Autorizimit Final sipas kësaj rregulle do t'i dorëzohet aplikuesit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Neni 17

Refuzimi për dhënien e autorizimit

1. Nëse ZRRE vlerëson se aplikuesi nuk i ka plotësuar kërkesat ose kushtet e përcaktuara sipas kësaj rregulle, atëherë do ta refuzojë dhënien e Autorizimit Preliminar apo Autorizimit Final.



2. Çdo vendim i ZRRE-së për refuzim të Autorizimit Preliminar apo Autorizimit Final sipas kësaj rregulle, duhet:
 - 2.1. t'i dorëzohet me shkrim aplikuesit duke përfshirë arsyet e refuzimit; dhe
 - 2.2. të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Neni 18

Aplikacioni për licencim

Para përfundimit të ndërtimit, por jo më vonë se gjashtë (6) muaj para finalizimit të stabilimentit të ri gjenerues, poseduesi i Autorizimit Final duhet të bëjë aplikimin për Licencë për kapacitetet gjeneruese mbi 5 MW, sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.

KREU V

MODIFIKIMI I AUTORIZIMIT

Neni 19

Modifikimi

1. Modifikimi i Autorizimit mund të iniciohet nga ZRRE ose me kërkesën e mbajtësit të Autorizimit, brenda afatit ligjor të përcaktuar në Vendimin për Autorizimin Final.
2. Kushtet e Autorizimit për ndërtimin e stabilimenteve të reja mund të modifikohet me anë të Vendimit të ZRRE-së, në mënyrën e specifikuar me këtë rregull.
3. Modifikimi i Autorizimit nuk zbatohet në mënyrë retroaktive.

Neni 20

Njoftimi për Modifikim

1. Njoftimi për fillimin e modifikimit të Autorizimit për gjeneratorët e mëdhenj ose gjeneratorët e vegjël do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
2. Njoftimi duhet të përfshijë:
 - 2.1. arsyet për fillimin e modifikimit;
 - 2.2. vlerësimin e efekteve të mundshme; dhe
 - 2.3. një shpjegim se çdo palë e interesuar mund të shpreh interesin apo të kundërshtojë një modifikim të tillë brenda tetë (8) ditësh kalendarike në ZRRE nga data e shpalljes së njoftimit.

Neni 21

Vendimet për Modifikim

1. Për të vendosur lidhur me modifikimin e Autorizimit, ZRRE do të marrë parasysh:



- 1.1. arsyetimet e dhëna nga mbajtësi i Autorizimit;
 - 1.2. vërejtjet e dorëzuara nga palët e tjera;
 - 1.3. dëshmitë (lejet) e nevojshme të lëshuara nga institucionet relevante dhe
 - 1.4. konsistenca e modifikimit duhet të përputhet me kriteret në bazë të cilave është bërë dhënia e autorizimit.
2. Vendimi i ZRRE-së për modifikim sipas kësaj rregulle do t'i dorëzohet palës dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Neni 22

Përfundimi i Autorizimit

1. Autorizimi mund të përfundojë në përputhje me afatet dhe kushtet e dhënies së Autorizimit.
2. ZRRE mund të përfundojë Autorizimin në rast se:
 - 2.1. mbajtësi i Autorizimit bën shkelje të kushteve të përfshira në Autorizim, shkelje të Ligjeve në fuqi, kësaj rregulle ose rregullave të tjera në fuqi;
 - 2.2. dhënia e Autorizimit është bazuar në informacione materialisht të rreme ose të gabuara;
 - 2.3. skadimi i periudhës së vlefshmërisë së Autorizimit ndodh para se të finalizohet stabilimenti;
 - 2.4. me kërkesë të mbajtësit të Autorizimit;
 - 2.5. shpërbëhet personi juridik që mban Autorizimin;
 - 2.6. nëse gjykata ka marrë një vendim me të cilin e shpall financiarisht të paafte mbajtësin e Autorizimit ose ndërpret aktivitetin e mbajtësit të Autorizimit;
 - 2.7. mbajtësi i Autorizimit kryen aktivitete në kundërshtim me autorizimin; dhe
 - 2.8. ndodh mospagesa e gjobës, e shqiptuar për mospërmbushje të kushteve të Autorizimit, siç është përcaktuar në Nenin 23 të kësaj rregulle.

Neni 23

Dispozitat ndëshkimore

1. Nëse ndonjë person fizik apo juridik fillon ndërtimin e stabilimentit të ri pa pasur Autorizim të lëshuar në përputhje me këtë rregull, ai person mund të gjobitet sipas Nenit 57 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullës për Masat Administrative dhe Gjobat e nxjerr nga ZRRE.
2. Nëse mbajtësi i autorizimit kryen ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese në kundërshtim me kushtet e dhëna me Autorizim, mund ti shqiptohet gjoba sipas Rregullës për Masat Administrative dhe Gjobat e nxjerr nga ZRRE.
3. Nëse vendoset gjoba sipas këtij neni, ZRRE do të njoftojë personin për shkeljen dhe do t'i japë një mundësi për t'u përgjigjur me shkrim, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh kalendarike nga data e njoftimit.
4. Nëse gjoba e shqiptuar nga ZRRE nuk paguhet brenda afatit të përcaktuar ligjor, ZRRE do të fillojë procedurën gjyqësore për pagesën e gjobës si borxh civil.



5. Nëse mbajtësi i Autorizimit nuk arrin t'i përmbushë kushtet e përcaktuara në Autorizim apo nuk përmbush ndonjë nga kërkesat e përcaktuara me këtë rregull, ZRRE mund ta shfuqizojë Autorizimin ose ta refuzojë dhënien e licencës për kapacitetet mbi 5 MW për operim të stabilimentit të ri gjenerues për të cilin është lëshuar Autorizimi.
6. Shfuqizimi i Autorizimit dhe refuzimi i dhënies së Licencës janë sanksione serioze dhe duhet të aplikohen vetëm pasi që bartësit të Autorizimit i është dhënë mundësia për të korigjuar shkeljet e bëra.

Neni 24

Apelimi i vendimit të ZRRE-së

Vendimi i ZRRE-së lidhur me lëshimin apo refuzimin për dhënien e Autorizimit mund të kontestohet vetëm në gjykatën kompetente, sipas legjislacionit në fuqi.

KREU VI DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 25

Ky Rregull nuk mbulon procedurën për ndërtimin e gjeneratorëve që prodhojnë energji elektrike për konsum vetanak (vet konsum).

Neni 26

Gjuha zyrtare

Kjo rregull është nxjerrë në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

Neni 27

Ndryshimi

1. ZRRE mban të drejtën që ta ndryshoj ose ta modifikojë çdo dispozitë të kësaj rregulle.
2. Procedurat për ndryshim ose modifikim të kësaj rregulle do të jenë të njëjta si për miratimin e saj.

Neni 28

Interpretimi

Në rast se ka paqartësi për dispozitat e kësaj rregulle, Bordi do të nxjerrë informacione shpjeguese.

Neni 29

Shfuqizimi

Kjo rregull shfuqizon Rregullën e Procedurës së Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të Reja , të nxjerrë në bazë të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 03/L-185 dhe miratuar nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji më 11.11.2014.



Neni 30
Hyrja në fuqi

Kjo rregull hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Bordi i ZRRE-së:

Krenar Bujupi, U.D. kryesues

Arsim Janova, anëtar

Besim Sejfiqaj anëtar.



Shtojca 1

APLIKACION PËR AUTORIZIM- Gjenerator të mëdhenj

INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME MBI APLIKUESIN					
EMRI I APLIKUESIT (PERSONIT JURIDIK):					
SELIA:					
ADRESA:					
NR. I REGJISTRIMIT:					
NR. I TELEFONIT:			NR. I FAKSIT:		
ADRESA E E-MAIL-IT:					
EMRI DHE MBIEMRI I PERSONIT KONTAKTUES:					
ADRESA:					
NR. I TELEFONIT:			NR. I FAKSIT:		
ADRESA E E-MAIL-IT:					
INFORMACIONE SPECIFIKE PËR GJENERATORIN, SIPAS NJËSIVE					
EMRI I NJËSISË	LOKACIONI	KOMUNA	BURIMI I ENERGJISË	KAPACITETI I INSTALUAR (MW)	PRODHIMI (VJETOR)



Udhëzime për plotësim

- 1) Aplikuesi duhet të bashkëngjisë të gjitha dokumentet/dëshmitë e mëposhtme dhe t'i dorëzojë në ZRRE, së bashku me aplikacionin, në përputhje me këtë rregull.
- 2) Çdo dokument i bashkëngjitur duhet të shënohet qartë me një tregues që i referohet dokumentit përkatës.
- 3) Aplikacioni duhet nënshkruar nga aplikuesi ose përfaqësuesi ligjor i autorizuar.
- 4) Për secilën pikë nga 1 deri 24, të bashkëngjitet një deklaratë e vulosur dhe e nënshkruar nga aplikuesi.

A: Kërkesa të përgjithshme

Nr.	Dëshmitë/dokumentet që duhet bashkëngjitur:	Shëno me PO ose JO:	
		PO	JO
1.	Certifikata e regjistrimit si një kompani afariste të lëshuar nga ARBK.		
2.	Dëshmi për themelimin e shoqatës, partneritetit apo konzorciumit, (Statuti i Shoqërisë/Kontratat etj.)		
3.	Dëshmi nga gjykata kompetente që aplikuesi nuk është në procedurë likuidimi/falimentimi, që biznesi i tij nuk administrohet nga gjykata dhe që aktivitetet e tij komerciale nuk janë të pezulluara;		
4.	Dëshmi nga organi kompetent që aplikuesi i përmbush detyrimet ligjore lidhur me pagimin e taksave në vendin ku është regjistruar si person juridik;		
5.	Dëshmi për përfaqësuesin ligjor të autorizuar të aplikuesit (Vendimi i Bordit ose ndonjë dokument tjetër që dëshmon kompetencat e personit.)		
6.	Dëshmi për rolin e secilit anëtar të Partneritetit lidhur me Projektin: a) Marrëveshjet financiare, b) Ekzekutimin e kontratës/ave Inxhinierike, të Prokurimit dhe Ndërtimit (IPN). Në rast se anëtarët e Partneritetit nuk sigurojnë të gjitha shërbimet kryesore për Projektin, atëherë bashkëngjisni dëshmi/kontrata për partnerët e propozuar (p.sh. për ndërtim, furnizim me teknologji, etj.).		
7.	Dëshmi lidhur me përvojën e aplikuesit/anëtarëve të partneritetit, sipas pikës 6 më sipër (Lista e projekteve referencë ku specifikohet vendndodhja, data e fillimit dhe data e përfundimit të projektit etj.).		
8.	Dëshmi për mënyrën e financimit të projektin nga aplikuesi, (bashkëngjisni letrat e synimit të ndonjë huadhënësi).		
9.	Dëshmi që konfirmon se aplikuesi dhe/ose anëtarët e tjerë të partneritetit		



Nr.	Dëshmitë/dokumentet që duhet bashkëngjitur:	Shëno me PO ose JO:	
		PO	JO
	janë entitete të krijuara si duhet, sipas ligjeve në vendin ku janë themeluar.		
10	Dëshmi (informacione/tregues financiarë) në lidhje me situatën financiare të aplikuesit (bashkëngjisni Raportin Vjetor Financiar të Audituar për tre (3) vitet e fundit, të vërtetuar nga institucioni kompetent ose nga auditorët financiarë të certifikuar).		

B: Kërkesa teknike dhe organizative

Nr.	Dëshmitë/dokumentet që duhet bashkëngjitur:	Shëno me PO ose JO	
		PO	JO
11	Strukturën organizative të aplikuesit për realizimin e projektit/stabilimentit.		
12	Biografite (CV-të) e e përfaqësuesit të autorizuar, stafit menaxhues dhe stafit tjetër të lartë të aplikuesit.		
13	Plani i Biznesit duke përfshirë edhe: Koston totale të investimeve dhe mënyrën e financimit; Vlerësimin ekonomik – financiar të projektit duke përfshirë pasqyrat financiare; Vlerësimin statik dhe vlerësimin dinamik të efikasitetit të investimeve (PBP, NPV,IRR dhe BP); Analizat e ndjeshmërisë NPV,IRR, PBP dhe LDC(kosto njësi marginale) përkundrejt investimit total, të hyrave dhe kostos së O&M si dhe Konkluzione dhe rekomandimet.		
14	Dëshmi (ose deklaratë) që përshkruajnë se kujt propozon aplikuesi t'ia shesë energjinë.		
15	Marrëveshjen për kyçje në rrjet (ofertën për kyçje, pëlqimin elektroenergetik, etj).		
16	Dëshmi lidhur me të drejtën për shfrytëzim të tokës dhe për gjendjen pronësore të tokës që do të përdoret për ndërtimin e Stabilimentit të ri (Vendimi për dhënie të pëlqimit nga organet komunale, fletët poseduese, kopjet e planit, marrëveshjet/kontratat për shfrytëzim të tokës private ose publike etj.).		
17	Leja ndërtimore		
18	Kërkesa mjedisore. Dëshmi që konfirmojnë se Stabilimenti i planifikuar që do të ndërtohet, do të jetë në pajtueshmëri me ligjet mjedisore në Kosovë (, Pëlqimin Mjedisor dhe Lejen Mjedisore pas ndërtimit të gjeneratorit të ri).		
19	Kërkesat e tjera relevante legjislative, përfshirë edhe të drejtat mbi ujin. Dëshmi nga autoritetet relevante që konfirmojnë se aplikuesi i ka plotësuar të gjitha kërkesat e aplikueshme statusore sipas legjislacionit relevant në Kosovë (varësisht prej projektit), përfshirë edhe të drejtat mbi ujin aty ku aplikohen.		



Nr.	Dëshmitë/dokumentet që duhet bashkëngjitur:	Shëno me PO ose JO	
		PO	JO
20	Dëshmi për llojin, sigurinë, kualitetin e paneleve solare/fotovoltaike si dhe certifikatën mbi riciklimin (TUV certifikata).		

C: Kërkesa financiare

Nr.	Dëshmitë/dokumentet që duhet bashkëngjitur:	Shëno me PO ose JO:	
		PO	JO
21.	Studimi i fizibilitetit teknik bazuar në të dhëna dhe matje reale të kryera në zonat e zbatimit të projektit ku të përfshihen: përshkrimi i përgjithshëm i projektit, kushtet klimatike dhe meteorologjike për zonën e projektit sipas tipit të gjeneratorit; përshkrimi teknik i zgjedhjes së çdo elementi të gjeneratorit bazuar në të dhënat e mësipërme; llogaritjet në të cilat bazohen përzgjedhjet e kryera; studimi, llogaritjet dhe përzgjedhjet e pajisjeve për lidhjen me sistemin e rrjetit të energjisë; studimi dhe analize e kushteve gjeologjike-inxhinierike të zonës ku do të zbatohet projekti.		
22.	Kërkesa për Pranim në Skemën Mbështetëse, sipas shtojcës 1 të Rregullës për pranim në Skemën Mbështetëse për Burimet e Ripërtritshme të Energjisë.		

Shpjegim i shkurtesave

BPP – Periudha e vetëshlyerjes së projektit

NPV – Vlera neto prezente e projektit

IRR – Norma interne e rentabilitetit (e brendshme e kthimit)

BP - Pragu i rentabilitetit.



Shtojca 2

APLIKACION PËR AUTORIZIM –Gjenerator të vegjël

INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME MBI APLIKUESIN					
EMRI I APLIKUESIT (PERSONIT JURIDIK):					
SELIA:					
ADRESA:					
NR. I REGJISTRIMIT:					
NR. I TELEFONIT:			NR. I FAKSIT:		
ADRESA E E-MAIL-IT:					
EMRI DHE MBIEMRI I PERSONIT KONTAKTUES:					
ADRESA:					
NR. I TELEFONIT:			NR. I FAKSIT:		
ADRESA E E-MAIL-IT:					
INFORMACIONE SPECIFIKE PËR GJENERATORIN, SIPAS NJËSIVE					
EMRI I NJËSISË	LOKACIONI	KOMUNA	BURIMI I ENERJISË	KAPACITETI I INSTALUAR (MW)	PRODHIMI (VJETOR)



Udhëzime për plotësim

- 5) Aplikuesi duhet të bashkëngjisë të gjitha dokumentet/dëshmitë e mëposhtme dhe t'i dorëzojë në ZRRE, së bashku me aplikacionin, në përputhje me këtë rregull.
- 6) Çdo dokument i bashkëngjitur duhet të shënohet qartë me një tregues që i referohet dokumentit përkatës.
- 7) Aplikacioni duhet nënshkruar nga aplikuesi ose përfaqësuesi ligjor i autorizuar.
- 8) Për secilën pikë nga 1 deri 11, të bashkëngjitet një deklaratë e vulosur dhe e nënshkruar nga aplikuesi.

A: Kërkesa të përgjithshme

	Dëshmitë/dokumentet që duhet bashkëngjitur:	Shëno me PO ose JO:	
		PO	JO
1.	Certifikata e regjistrimit si një kompani afariste të lëshuar nga ARBK.		
2.	Dëshmi për themelimin e shoqërisë (Statuti i Shoqërisë.)		
3.	Dëshmi nga gjykata kompetente që aplikuesi nuk është në procedurë likuidimi/falimentimi, që biznesi i tij nuk administrohet nga gjykata dhe që aktivitetet e tij komerciale nuk janë të pezulluara;		
4.	Dëshmi nga organi kompetent që aplikuesi i përmbush detyrimet ligjore lidhur me pagimin e taksave në vendin ku është regjistruar si person juridik;		
5.	Dëshmi për përfaqësuesin ligjor të autorizuar të aplikuesit (Vendimi i Bordit ose ndonjë dokument tjetër që dëshmon kompetencat e personit.)		

B: Kërkesa teknike dhe organizative

	Dëshmitë/dokumentet që duhet bashkëngjitur:	Shëno me PO ose JO	
		PO	JO
6.	Marrëveshjen për kyçe në rrjet (ofertën për kyçe, pëlqimin elektroenergjetik, etj).		
7.	Plani i Biznesit duke përfshirë edhe: Koston totale të investimeve dhe mënyrën e financimit; Vlerësimin ekonomik – financiar të projektit duke përfshirë pasqyrat financiare; Vlerësimin statik dhe vlerësimin dinamik të efikasitetit të investimeve (PBP, NPV,IRR dhe BP); Analizat e ndjeshmërisë NPV,IRR, PBP dhe LDC(kosto njësi marginale) përkundërt investimit total, të hyrave dhe koston së O&M si dhe Konkluzione dhe rekomandimet.		
8.	Dëshmi lidhur me të drejtën për shfrytëzim të tokës dhe për gjendjen pronësore të tokës që do të përdoret për ndërtimin e Stabilimentit të ri (Vendimi për dhënie të pëlqimit nga organet komunale, fletët poseduese, kopjet e planit, marrëveshjet/kontratat për shfrytëzim të tokës private ose publike etj.).		
9.	Kërkesa mjedisore.		



	Dëshmitë/dokumentet që duhet bashkëngjitur:	Shëno me PO ose JO	
		PO	JO
	Dëshmi që konfirmojnë se Stabilimenti i planifikuar që do të ndërtohet, do të jetë në pajtueshmëri me ligjet mjedisore në Kosovë (, Pëlqimin Mjedisor dhe Lejen Mjedisore pas ndërtimit të gjeneratorit të ri).		
10.	Kërkesat e tjera relevante legjislative, përfshirë edhe të drejtat mbi ujin. Dëshmi nga autoritetet relevante që konfirmojnë se aplikuesi i ka plotësuar të gjitha kërkesat e aplikueshme statusore sipas legjislacionit relevant në Kosovë (varësisht prej projektit), përfshirë edhe të drejtat mbi ujin aty ku aplikohen.		
11.	Leja ndërtimore		
12.	Dëshmi për llojin, sigurinë, kualitetin e paneleve solare/fotovoltaike si dhe certifikatën mbi riciklimin (TUV certifikata).		

C: Kërkesa financiare

	Dëshmitë/dokumentet që duhet bashkëngjitur:	Shëno me PO ose JO:	
		PO	JO
13.	Kërkesa për Pranim në Skemën Mbështetëse, sipas shtojcës 1 të Rregullës për pranim në Skemën Mbështetëse për Burimet e Ripërtritshme të Energjisë.		